



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21.02.2025

Nr: 133

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 31 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 21.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Zj. Antoneta Çuni**
Kryetar i Këshillit Bashkiak Fier

Z. Arnando Çupa
Sekretar i Këshillit Bashkiak Fier

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht miratimi i akteve nënligjore për dhënien e tokave me qira para fushatës zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 31 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

Data: 21.02.2025

Nr: 133
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 31 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

“Sipas denoncimeve të shumta në media, rezulton se në mbledhjen e datës 30 janar të Këshillit Bashkiak në Fier janë miratuar katër projektvendime për dhënie me qira të pasurive publike të cilat u morën më shumicën e votave të këshilltarëve socialistë.

Në faqen zyrtare të Bashkisë Fier është publikuar vetëm shkresa “Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak”, që mban datën 22.01.2025 ndërsa projektvendimet nuk gjenden të publikuara, duke shkelur në këtë mënyrë edhe parimin e transparencës. Kopje të kësaj shkrese do ta vendosim në dispozicion për shqyrtimin tuaj. ”

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Antoneta Çuni, Kryetar i Këshillit Bashkiak Fier;
 - Z. Armando Çupa, Sekretar i Këshillit Bashkia, Fier
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI